**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA E NOTERËVE** [illegible]
**NR.** 8245 **REP.**
**NR.** 1230 **KOL.**

## KONTRATË PËR SHITJEN E KUOTAVE TË SHOQËRISË "FLU-TO-NE" Sh.p.k.

Sot në [illegible], më datë 23/07/2008, përpara meje Noterit të Dhomës së Noterëve [illegible] u paraqitën personalisht palët e mëposhtme:

Z. Tomorr MUÇOLLARI, i biri i Ramadanit, lindur në Këlcyrë, Përmet me 1965, me pasaportë nr. Z 0528527 ne cilësinë e Ortakut mazhoritar si mbajtës i 71% (shtatëdhjetë e një përqind) të kuotave të shoqërisë "Flu-To-Ne" Sh.p.k., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe që ushtron aktivitetin e saj sipas legjislacionit shqiptar, e regjistruar si person juridik në Regjistrin Tregtar me Vendimin nr. 26.586 datë 30/10/2001, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (ne vijim "***Shitësi***");

**dhe**

**Z.** Z. Fluturim MUÇOLLARI, i biri i Ramadanit, lindur në Këlcyrë, Përmet me 1969, me pasaportë nr. Z 0794228, zotërues i 29% (njëzetë e nëntë përqind) të kuotave të shoqërisë "Flu-To-Ne" Sh.p.k., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe që ushtron aktivitetin e saj sipas legjislacionit shqiptar, e regjistruar si person juridik në Regjistrin Tregtar me Vendimin nr. 26.586 datë 30/10/2001, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (ne vijim "***Blerësi***");

**MEQENËSE**

a) **Shitësi**, zotëron 71 (shtatëdhjetë e një) kuota, qe përfaqësojnë 71 % te kapitalit themeltar te shoqërisë "Flu-To-Ne" Sh.p.k., (ne vijim "Shoqëria"), shoqëri e regjistruar ne Regjistrin Tregtar Shqiptar me vendim nr. 26.586 datë 30/10/2001, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe me kapital prej 100.000 (njëqind mijë) LEKË, të përbërë nga 100 (njëqind) kuota me vlere nominale 1.000 (njëmijë) leke secila;

b) **Shitësi** dëshiron te transferoje 21 (njëzetë e një) kuota nga 71 (shtatëdhjetë e një) kuotat qe zotëron ne këtë shoqëri, te cilat përfaqësojnë 71% të kapitalit të saj fillestar;

c) **Blerësi** dëshiron të fitojë pronësinë e 21 (njëzetë e një) kuotave, që përfaqësojnë 21% (njëzetë e një përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë;

Palët bien dakord për sa me poshtë vijon:

**1. Objekti i Kontratës**

1.1 Sipas kushteve të parashikuara në këtë Kontratë, **Shitësi** bie dakord të transferojë tek **Blerësi** dhe ky i fundit bie dakord të bëhet titullar i 21 (njëzetë e një) kuotave që përfaqësojnë 21% të pjesëve të kapitalit themeltar të Shoqërisë të zotëruara nga **Shitësi**;

**2. Çmimi i shitjes**

2.1 Çmimi për transferimin e 21 kuotave që zotëron Shitësi është rënë dakord nga palët të jetë çmimi total prej 21.000 (njëzetë e një mijë) Lekë. Pronësia mbi kuotat transferohet nga Shitësi tek Blerësi me nënshkrimin e kësaj kontrate.

2.2 Çmimi i shitjes i është paguar Shitësit plotësisht nga Blerësi jashtë zyrës noteriale.

**3. Garancitë**

3.1 Shitësi garanton dhe deklaron se pjesët e kapitalit që transferon nëpërmjet kësaj kontrate janë të lira nga çdo barrë apo pretendim tjetër ligjor i të tretëve mbi to.

**4. Të ndryshme**

4.1 Pas transferimit të pjesëve të kapitalit tek Blerësi, ky fiton zotërimin e 21 (njëzetë e një) kuotave, që përfaqësojnë 21% të kapitalit themeltar te Shoqërisë dhe bëhet Ortaku i Barabartë në Shoqëri.

4.2 Shoqëria do të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin në Qendrën Kombëtare për Regjistrim të kësaj kontrate për transferimin e kuotave të kapitalit. Me nënshkrimin e kësaj kontrate Shitësi humbet të drejtën e pjesëmarrjes në fitim, reklamimin e dividendëve, të drejtën e votës dhe çdo të drejtë tjetër që rrjedh nga zotërimi i këtyre 21 (njëzetë e një) kuotave te kapitalit të Shoqërisë që transferohen dhe Blerësi bëhet titullar i vetëm i ligjshëm i tyre.

4.3 Kjo kontratë hartohet në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Kjo kontratë pasi u lexua, prej meje Noterit, u gjet në përputhje me vullnetin e lirë e të plotë të palëve, u nënshkrua rregullisht prej tyre në praninë time dhe unë Noteri e vërtetoj këtë sipas ligjit.

| | |
|---|---|
| **Shitësi** | **Blerësi** |
| **Tomorr MUÇOLLARI** | **Fluturim MUÇOLLARI** |

**NOTERI**

DHOMA E NOTERËVE
GJIROKASTËR
NOT. GRETA KALLOJERI
TEL. 2..

